



KONTROLI I LARTË I SHETIT K R Y E T A R I

Nr. 1234/7 Prot.

Tiranë, më, 28/4/2017

V E N D I M

Nr. 36, Datë 28.4.2017

PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË ÇËRRIK "MBI AUDITIMIN E PËRPUTHSHMËRISË DHE LIGJSHMËRISË FINANCIARE"

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Njësisë të Qeverisjes Vendore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15 dhe 30, të ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

V E N D O S A:

- I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Për auditimin e përputhshmërisë dhe ligjshmërisë financiare" të ushtruar në Bashkinë Çërrik, dhe njësitë administrative ish-Komunat Shalës, Mollas, Klos e Gostimë, për periudhën 01.01.2012 deri më 31.12.2016.
- II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Çërrik nuk janë ndërmarrë hapat ligjore për regjistrimin e pronave në pronësi të Bashkisë në ZVRPP Elbasan, në zbatim të kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në VKM nr. 500 datë 14.08.2001 "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore".

1.1 Rekomandimi: Bashkia Çërrik të marrë masat e nevojshme për regjistrimin e pronave dhe për krijimin e regjistrimit të pronave të paluajtshme të kaluara në pronësi, apo në përdorim të Bashkisë Çërrik.

Brenda muajit Qershor 2017

2. Gjetje nga auditimi: Për të gjitha asetet nuk është hapur regjistri kontabël, në kundërshtim me kapitullin III "Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre", pika 26 dhe 27 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pasi nëpunësi autorizues nuk ka caktuar nëpunësin zbatues për krijimin dhe mbajtjen e regjistrimit kontabël të të gjithë aktiveve, që zotëron apo ka në administrim Bashkia Çërrik. Po kështu në kundërshtim me pikën 31/d të udhëzimit të mësipërm, nuk është mbajtur regjistri i veçantë

për secilën nga pasuritë e dhëna me qira ku të përcaktohet sipërfaqja e objektit në metra katrorë, numri dhe data e kontratës së qirasë, afati i vlefshmërisë së kontratës, afati i qirasë, veprimtaria që kryhet, subjekti përfitues, qiraja mujore dhe arkëtimet sipas muajve të vitit kalendarik.

2. 1 Rekomandimi: Bashkia Cërrik, pas azhurnimit të aseteve të kaluara në pronësi me VKM nr. 1032, datë 08.10.2009 dhe aplikimit për regjistrim në ZVRPP Përmet në pronësi të Bashkisë, përkatësisht në regjistrin e kartelave të pasurive të paluajtshme, të krijojë dhe mbajë regjistrin kontabël të tyre, si dhe të përditësojë regjistrin mbi pasuritë e paluajtshme të dhëna me qira, qofshin këto në format e trualli të lirë, apo të pajisur me infrastrukturë.

Brenda muajit Qershor 2017

3. Gjetje nga auditimi: Në ish-Komunën Shalës janë lidhur marrëdhënie kontraktuale në 121 raste për një sipërfaqe 96 ha, për të cilat administrohet vetëm kontrata dhe asnjë akt tjetër, me afat 99 vjet në kundërshtim me nenin 678, të Kodit Civil, VKM. 531, datë 21.8.1998 “Për tokat bujqësore të pandara” i ndryshuar, pika 5 e Udhëzimit të KM nr. 1, datë 18.07.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore, të pandara”, me Urdhrin e Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit nr. 13, datë 15.01.2013 “Për miratimin e përmbajtjes dhe formës së “Kontratës Tip për dhënien me qira të tokave bujqësore, të pandara”.

3.1 Rekomandimi: Bashkia Cërrik të marrë masa për rishqyrtimin duke vlerësuar edhe anulimin e 121 kontratave për një sipërfaqe 96 ha, të lidhura në kundërshtim me nenin 678, të Kodit Civil, VKM. 531, datë 21.8.1998 “Për tokat bujqësore të pandara” i ndryshuar, pika 5 e Udhëzimit të KM nr. 1, datë 18.07.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore, të pandara”, me Urdhrin e Ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit nr. 13, datë 15.01.2013 “Për miratimin e përmbajtjes dhe formës së “Kontratës Tip për dhënien me qira të tokave bujqësore, të pandara”.

Brenda muajit Qershor 2017

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se mbi zbatimin e planeve të punës nuk ka gjurmë shpresore mbi zbatimin e tyre, duke lënë hapësirë për përmbushjen e plotë të detyrës funksionale të IMTV-së dhe konstatimeve të veprimeve në papërputhshmëri me ligjin nr. 9780, 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit” i ndryshuar dhe VKM-së nr. 862, datë 05.12.2007 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga INUK dhe INUV”.

4. 1 Rekomandim: Bashkia Cërrik dhe IMTV të marrin masa dhe të dokumentojnë veprimtarinë funksionale në zbatim të planeve të punës ditore, mujore dhe vjetore duke lënë gjurmë me anë të akteve administrative në zbatim të ligjit nr. 9780, 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, të ndryshuar me ligjin nr. 183/2014 datë 01.04.2013 dhe VKM nr. 894, datë 4.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Dosjet teknike të investimeve të cilat u audituan rezultuan me mangësi në dokumentacion, veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, pika 4, paragrafi 4.

5.1 Rekomandim: Bashkia Cërrik, nëpërmjet Zyrës së Planifikimit të Territorit, të marrë masa për plotësimin e dokumentacionit të dosjeve teknike të investimeve gjatë procesit të zbatimit të kontratave deri në dorëzimin e objektit.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Cërrik dhe 3-ish Komunitat Klos, Mollas dhe Shalës për periudhën 2009-2013 u janë dhënë me qira 792 ha, toka bujqësore të pandara 602 qiramarësve, respektivisht: Bashkia Cërrik 18 ha për 7 persona; Njësia Administrative Klos 16ha për 41 persona, Shalës 96 ha për 121 persona dhe Mollas 662 ha për 433 persona, pavarësisht se deri më datën 31.12.2016 nuk kanë paguar shumën prej **32,208,451 lekë**.

Nga ish-Komunat dhe pas reformës territoriale dhe bashkimin me Bashkinë Cërrik, në asnjë rast për dhënien me qira për tokat e pandara (pavarësisht se pjesa me e madhe sipërfaqes janë mbjelle me ullinj), nuk është bërë **kontrolli i respektimit të kushteve të kontratës**, në kundërshtim me pikën 5, shkronja (d) të Udhëzimit KM nr. 1, datë 18.07.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore, të pandara”.

6.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Cërrik, të ngrejë një grup pune me pjesëmarrjen Drejtorisë Taksave, Drejtorisë Financës, Drejtorisë Bujqësisë, Drejtorisë Juridike, Topografë, Njësitë Administrative, etj, me qëllim verifikimin e zbatimit të kushteve të përcaktuara në 602 kontratat e lidhura për sipërfaqen prej 792 ha, për dhënien me qira në vite të tokave bujqësoret pandara.

Krahas kësaj të kryhet edhe kontrolli dhe statusi juridik i tokave të dhëna me qira (Pajisja me Certificate regjistrimi në Hipotekë, etj,nga vete Bashkia Cërrik dhe Njësitë Administrative të Bashkisë Cërrik (Mollas dhe Klos) dhe përveç tokës së dhënë me qira, të verifikohet edhe rastet e zaptimit të tokës, mbi sasinë e përcaktuar në kontratat dy paleshe.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Për periudhën 3vjeçare 2013-2016 në Bashkinë Cërrik nuk janë realizuar të ardhurat nga taksat dhe tarifrat në vlerën 30,365,632 lekë. Bashkia Cërrik edhe pse ka mazhorancën e aksioneve në Ujësjeles sh.a Cërrik dhe për vitin 2016 kanë patur përfaqësues në Këshillin Administrativ të krijuar kohët e fundit, ndërkohë nuk ka mundur lidhjen e një marrëveshje, në të cilën Ujësjelesi sh.a. Cërrik të përcaktohet si agjent tatimor, për arkëtimin e taksave vendore së bashku me faturat e ujit të pijshëm, bazuar në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5 shkronja (ii), neni 7 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore” i ndryshuar, pikës 7.1 të UMF nr. 24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore” i ndryshuar, marrëveshje e cila do të rriste arkëtimin e taksave vendore dhe do rigjenerojë të ardhura për Bashkinë Cërrik.

7.1. Rekomandimi: Bashkia Cërrik të përgatisë aktmarrëveshjen me Ujësjeles sh.a. Cërrik, për kryerjen nga ana e këtij të fundit të agjentit tatimor për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore së bashku me faturat e ujit të pijshëm, marrëveshje e cila duhet të miratohet në Këshillin Bashkiak bazuar në legjislacionin në fuqi.

Në mbledhjen më të afërt të Këshillit Bashkiak

8. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Cërrik nuk u gjet regjistri i raportimeve dhe masave të marra për parandalimin e mashtrimit dhe parregullsive, ndërkohë për minimizimin e riskut, mashtrimit dhe parregullsive nga nëpunësi autorizues nuk janë regjistruar dhe raportuar masat e marra për parandalimin e tyre sipas nenit 21, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

8.1. Rekomandim:

a. Nga ana e grupit të menaxhimit strategjik të njësisë publike, të merren masa për hapjen dhe mbajtjen e regjistrimit të raportimeve dhe masave të marra për parandalimin e mashtrimit dhe parregullsive.

b. Për minimizimin e riskut, mashtrimit dhe parregullsive, nga nëpunësi autorizues të regjistrohen dhe raportohen masat e marra për parandalimin e tyre, gjithashtu të miratohet dhe vihet në funksionim sistemi informacionit dhe komunikimit.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Mbështetur në evidencat e dhëna nga zyra e burimeve njerëzore, verifikuar nga ana jonë ky informacion me urdhrat origjinal të nxjerra nga Kryetari i Bashkisë, konstatohet se për të gjithë periudhën e audituar janar 2012 - qershor 2016 në pozicione pune të cilët mbulohen nga statusi për nëpunësin civil, rezulton se janë marrë në **punë 10 punonjës**, pa u zbatuar procedurat e rekrutimit për pranimin dhe emërimin në shërbimin civil, në kundërshtim me nenin 20, 22 dhe 23 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil.

9.1. Rekomandim: Bashkia Cërrik të marrë masa për rekrutimin e punonjësve në pozicione pune të shërbimit civil në përputhje me ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” duke nxjerrë përgjegjësinë për shkaktarët.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi:

a-Bashkia Cërrik është penalizuar nga gjykata për largime nga puna të punonjësve për zgjidhje të kontratës së punës në kundërshtim me nenet 144, 153 dhe 154 të ligjit nr. 7961, datë 11.7.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, dhe me pikën 62 të UMF nr. 2 datë 6.2.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, duke rënduar padrejtësisht shpenzimet e institucionit në vlerën përballuar **4,206,687 lekë**, ç’ka kanë ndikuar negativisht në buxhetin e NJQV. Pavarësisht ndjekjes në rrugë ligjore të çështjeve në gjykatë për dëmshpërblimet për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës, përgjegjësia është tërësisht e institucionit, i cili nuk ka analizuar të gjitha vendimet, që kanë sjellë dëm efektiv për buxhetin e shtetit dhe nuk ka kërkuar nxjerrjen e përgjegjësive administrative për shkaktarët.

b- Si rrjedhojë e mosrespektimit të procedurës së zgjidhjes së kontratës gjatë tremujorit të katërt të vitit 2015 dhe vitit 2016 rezultoi se janë ankimuar 13 punonjës të cilët në shkallën e parë kanë fituar një shpërblim nga 15,5 deri më 22 paga secili. Nga ana e Bashkisë Cërrik është bërë apelimi i tyre në Gjykatën Administrative të Apelit sipas rasteve përkatëse.

10.1. Rekomandim:

a. Bashkia Cërrik të nxjerrë përgjegjësit për ndërprerjen e marrëdhënieve financiare të punonjësve me Institucionin, për shkaqe të pa argumentuara dhe të pambështetura në dispozitat ligjore në fuqi, pasi për shkak të këtyre veprimeve, institucioni detyrohet të ekzekutojë vendime gjyqësore duke paguar shumën **4,206,687 lekë**.

b. Bashkia Cërrik, të ndjekë me përparësi dhe hap pas hapi në të gjitha e shkallët e gjyqësorit të 13 të çështjeve të ankimuar duke i analizuar dhe nxjerrë përgjegjësinë indirekte ndaj fajtorëve, në kundërshtim me pikën 62 dhe 102, të UMF nr. 2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, duke zbatuar me korrektësi të plotë udhëzimin nr. 1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësisve të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”, sipas pikës 2 të këtij udhëzimi.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Bashkia Cërrik, ka kryer pagesa të pajustificuara për gjoba të llogaritura dhe të vendosura nga DPSHTRR në *6 raste* për vlerën **17,539 lekë**, sipas urdhër shpenzimeve nr. 269, datë 12.11.2013, nr. 160, datë 09.05.2014, nr. 161, datë 09.05.2014, nr. 162, datë 09.05.2014, nr. 196, datë 21.05.2014 dhe nr. 62, datë 20.02.2015. Kamatëvonesat e llogaritura dhe gjobat e vendosura kanë të bëjnë me mos likuidim në kohë të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, mos likuidim në kohë të detyrimeve ndaj subjekti Ç..., për disa individë, por që janë përballuar nga buxheti i Komunës, pa vendim të Këshillit të Komunës, pa i diskutuar dhe pa nxjerrë përgjegjësinë për shkaqet dhe shkaktarët, në kundërshtim kjo me ligjin 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” me pikën 102, të UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit të shtetit”.

11.1. Rekomandimi: Bashkia Cërrik, ku bën pjesë Njësia administrative Gostimë, Mollas, Klos dhe Shalës të marrë masa dhe të analizojë në Këshillin Bashkiak këto pagesa dhe pas vendimit të kryhen veprimet përkatëse për sistemimin e vlerës **17,539 lekë**, duke kërkuar arkëtimin e kësaj vlere.

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi: Bashkia Cërrik për mungesë të paaftësisë paguese, sipas bilanceve kontabël të mbartura nga vitet e mëparshme më datën 31.12.2016 ka fatura të palikujduaraa të cilat janë pajisur me dokumentacionin ligjore të nevojshëm për vlerën **91,732,267 lekë**, të krijuara në vite përkatësisht;

Për vitin 2011 në vlerën 1,023,370 lekë, për vitin 2012 në vlerën 406,496 lekë, vitin 2013 për vlerën 9,707,042 lekë, për vitin 2014 në vlerën 38,970,847 lekë, për vitin 2015 për vlerën 34,602,632 lekë dhe për vitin 2016 për vlerën 7,022,267 lekë.

12.1. Rekomandim: Bashkia Cërrrik (Drejtoria Financë Buxhetit) në mbledhjen e këshillit bashkiak të analizojë gjendjen e faturave të palikujduara në vite, të hartojë një grafik për likuidimin e tyre, duke zbatuar të gjitha radhën e pagesave për likuidimin e detyrimeve të prapambetura për vlerën **91,732,267 lekë**.

Në mbledhjen me të afërt të Këshillit Bashkiak

13. Gjetje nga auditimi: Nga KLSH në auditimin e mëparshëm me shkresën nr. 679, Prot datë 21.07.2012, i janë rekomanduar Bashkisë Cërrrik, 12 masa organizative të cilat janë pranuar. Nga verifikimi rezulton se janë zbatuar 11 masa duke mos u zbatuar plotësisht 1 masë organizative dhe konkretisht rekomandimi nr. 7, për arkëtimin e taksave pasi është në proces zbatimi.

-Nga verifikimi rezulton se rekomandimi nr. 1, masa për shpërblim dëmi, për vlerën **378.359** lekë nuk është zbatuar, pasi deri më date 16.01.2017 megjithëse është bërë kontabilizimi nga vlera e rekomanduar prej 378.359 lekë, ende nuk ka filluar arkëtimi.

13.1. Rekomandimi: Drejtoria Juridike e Bashkisë Cërrrik të hartojë padi gjyqësore për shpërblimin e dëmit ekonomik në vlerën **378.359** lekë, ndaj 3 personave të rekomanduara në shkresën nr. 679 Prot., datë 21.07.2012 të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Menjëherë

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në pikën 5 neni 13, pika 14 neni 43, të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa VI, kreu I, nenet 105-109 dhe udhëzimin e Ministrit të Financave, nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kap IV, -Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 93, **nga ana e titullarit të njësisë publike**, (Nëpunësit Autorizues), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabile përfundimtare me qëllim për shpërblimin e dëmit në vlerën **44,823,104 lekë**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Në objektin “*Impianti i Kondicionimit dhe Punimeve të Rifiniturës se Drurit, Kati i Dytë, Bashkia Cërrrik*”, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultuan diferenca *më tepër në vlerë, në vlerën 694,296 lekë pa t.v.sh duke shkaktuar dëm ekonomik, si pasojë e përfshirjes në preventiv dhe situacionin përfundimtar të t.v.sh-së për pajisjet*, në kundërshtim VKM nr. 2 datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, pra nuk është ndarë veças vlera e “montimit” dhe veças vlera pajisjeve etj, e për rrjedhojë është rritur artificialisht vlera e kontratës në shumën **694,296 lekë** (3,471,480 x 20%), si dhe nga bashkimi i operatorëve ekonomik.

1.1 Rekomandim: Nga Bashkia Cërrrik të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **694,296 lekë** pa t.v.sh nga BOE “E...” sh.p.k dhe “S...” shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 2308/2 prot., datë 15.12.2016 me objekt “*Impianti i Kondicionimit dhe Punimeve të Rifiniturës se Drurit, Kati i Dytë, Bashkia Cërrrik*”, Bashkia Cërrrik vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si rrjedhojë e preventivimi, situacionimit dhe likuidimit të tvsh-së për pajisjet.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Në objektin “*Ndërtim i Linjës Kryesore K.U.Z, Lagja nr. 2*”, Bashkia Cërrrik, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të

punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultuan *punime të pakryera në fakt, duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 1,214,530 lekë pa tvsh*, në kundërshtim me kontratën nr. 985 prot., datë 26.10.2012 dhe preventivin e ofertës fituese paraqitur në tender.

2.1 Rekomandim: Bashkia Cërrik të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **1,214,530 lekë** pa tvsh nga OE “S...” shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën e sipërmarrjes nr. 985 prot., datë 26.10.2012 me objekt “Ndërtim i Linjës Kryesore K.U.Z, Lagja nr. 2”, Bashkia Cërrik, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit Bashkisë Cërrik si pasojë e situacionimit dhe likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Në objektin “**Rikonstruksion Ujësjiellësi i Fshatit Banjë e Re - Trunc**”, ish-Komuna Klos, Cërrik, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultuan *punime të pakryera në fakt, duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 1,841,000 lekë pa tvsh*, në kundërshtim me kontratën datë 09.12.2012 dhe preventivin e ofertës fituese paraqitur në tender.

3.1 Rekomandim: Bashkia Cërrik të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **1,841,000 lekë** pa tvsh nga OE “H...” shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën datë 09.12.2012 me objekt “*Rikonstruksion Ujësjiellësi i Fshatit Banjë e Re - Trunc*”, ish-Komuna Klos, Cërrik, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të Bashkisë Cërrik, si pasojë e situacionimit dhe likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Në objektin “**Rikonstruksion i Shkollës së Mesme të Bashkuar Shalës**”, ish-Komuna Shalës, Cërrik, nga auditimi i dokumentacionit teknik të zbatimit dhe mbikëqyrjes të punimeve të ndërtimit të administruara në dosjen teknike si dhe nga verifikimi në terren rezultuan rezultuan *punime të pakryera në fakt, duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 514,300 lekë pa tvsh*, në kundërshtim me kontratën datë 09.12.2012 dhe preventivin e ofertës fituese paraqitur në tender.

4.1 Rekomandim: Nga Bashkia Cërrik të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **514,300 lekë pa tvsh** nga OE “H...” shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 33 prot., datë 13.11.2012 me objekt “*Rikonstruksion i Shkollës së Mesme të Bashkuar Shalës*”, ish-Komuna Shalës, Cërrik, vlerë kjo e cila përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit të Bashkisë Cërrik, si pasojë e situacionimit dhe likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Për vitet 2012 deri 2016 nga Drejtorët dhe përgjegjëset e zyrës taksave dhe inspektorët e taksave edhe pse janë nxjerr listat e debitorëve nuk janë dërguar në zyrën e financës për tu regjistruar si debitorë, nuk janë kryer rakordime ndërmjet Drejtorisë Financës dhe Drejtorisë Taksave, duke mos hapur analizat (partitarët), në kundërshtim me nenet 6 dhe 7 të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe pikën 3 të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aseteve në sektorin publik”, rubrika “Dokumentimi i lëvizjeve të aktiveve”.

Me kërkesën e grupit të auditimit të KLSH gjatë periudhës së auditimit, u nxorën dhe rakorduan të dhënat për periudhën nga viti 2012 deri më datën 31.12.2016, për taksat e papaguara; nga bizneset, taksa e tokës, qiraja e tokave të pandara, taksat e popullatës, etj, respektivisht për Bashkinë Cërrik dhe 4 ish-komunat, aktualisht Njësitë Administrative, Mollas, Klos, Gostimë dhe Shalës, duke krijuar një të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Cërrik në vlerën **36,322,605 lekë**.

5.1 Rekomandimi: Drejtorja e Taksave dhe Drejtorja e Financës Bashkia Cërrik të marrë masa për kryerjen e akt rakordimeve për debitorët e taksave për periudhën 01.01.2012-deri më datën 31.12.2016 dhe pasqyrimin në kontabilitet të debitorëve të taksave mungesë të ardhurash me dëm ekonomik, në vlerën **36,322,605 lekë, respektivisht:**

-**në vlerën 32,208,451 lekë**, e cila përfaqëson vlerën e qirasë së papaguar dhe vlerën e kamat vonesa të llogaritura si pasojë e mos pagimit në afat sipas parashikimeve në kontata dypalëshe, për tokat e pandara në vite në Bashkinë Cërrik dhe 3 Njësitë Administrative Mollas, Klos dhe Shalës.

-**në vlerën 4,114,154 lekë**, nga mospagesa e 63 bizneseve detyrimet e taksave vendore Sa sipër, bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, nga Drejtorai e Taksave të nxiren njoftim vlerësimit tatimore dhe për arkëtimin e detyrimeve të mësipërme të ndiqen **rrugët e mëposhtme:**

a)-Tu dërgohen bankave urdhrat e bllokimit të llogarive në banka, bazuar në nenin 90 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008.

b-Ti dërgohen Drejtorisë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ZVRPP (për pasuritë e paluajtshme), bazuar në nenin 91 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008.

c- Për subjektet të cilët nuk kanë paguar detyrimet tatimore në afat, ndaj tyre të fillojë llogaritja e kamat vonesave, në masën 0,06% kamat vonesë të detyrimit në ditë por jo më tepër se 365 ditë (gjobë), bazuar në nenin 114 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008.

d-Në se edhe pas njoftimeve zyrtare Bizneset nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Bashkisë (Drejtoria e të Ardhurave dhe Drejtoria Juridike) të marrë masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhej kallëzim penal sipas nenit 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008.

e- Drejtoria e të ardhurave në Bashkinë Cërrik të listojë në mënyrë elektronike abonentët familjarë dhe të merren masa për arkëtimin e taksave taksave të popullatës, taksës tokës nga fermerët e 4 Njësite Administrative. Në zbatim të pikës 71, të udhëzimit plotësues të MF nr. 01, datë 15.01.2016 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016”, sipas të dhënave që disponon Gjendja Civile, të njoftohen tatimpaguesit familjarë me Njoftim vlerësimi tatimor edhe në median lokale (të Bashkisë Gramsh dhe 4 njësitë Administrative) për të paguar detyrimin tatimor të miratuar nga Këshilli Bashkiak, nëpërmjet dërgimit të njoftim vlerësimit me anë të zyrës postare, për të gjitha llojet dhe shumën e taksave të papaguara, si taksën e tokës, banesave dhe tarifat etj (*Listat e debitorëve për Bashkinë Cërrik dhe 4 Njësinë Administrative gjenden pranë Drejtorisë të Ardhurave Bashkia Cërrik, te printuara dhe në mënyrë elektronike (Anekset nr. 1,2 ,3, 4, 5 dhe 6 bashkëlidhur Raportiti Përfundimtar të Auditimit)*

Brenda muajit qershor 2017

6. Gjetje nga auditimi: Për periudhën e viteve 2012 deri 2016, disa këshilltarë të ish-Këshillave të komunave dhe Bashkisë Cërrik, janë paguar edhe për ditët që nuk kanë marrë pjesë në mbledhjen e këshillit të komunës, apo bashkisë, duke përfutuar padrejtësisht vlerën **3,629,845 lekë** dëm ekonomik për buxhetin e komunës. PAGESA KËTO TË KRYERA NË KUNDËRSHTIM ME PIKËN 2 TË NENIT 29, TË LIGJIT NR. 8652, DATË 31.07.2000 “Për organizimi dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me ligjin nr. 139/2014, ku përcaktohet: “Këshilltari shpërblehet për punën që kryen...”.

6.1 Rekomandim: Zyra e Financës në Bashkinë Cërrik të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **3,630,450 lekë** nga këshilltarët (*sipas listës të bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Brenda muajit qershor 2017

7. Gjetje nga auditimi: Në ish Komunën Mollas, sipas fletëdaljes nr. 23, datë 29.08.2014, i janë bërë dalje Makinës Tip ambulancë 600 litra gazoil me vlerë **109,200 lekë**, firmosur nga z. Sh.F. ish magazinier në ish Komunën e Mollasit dhe shoferi i ambulancës z. I.Ç. Bashkëlidhur fletëdaljes nr. 23, datë 27.08.2014, gjendet urdhër dorëzimi pa numër, datë 27.08.2014, lëshuar dhe e firmosur në cilësinë lëshueses së urdhrit nga znj. A.N. dhe tërheqësi i urdhrit dhe karburantit z. I.Ç. Nuk disponohen fletë udhëtimi për argumentimin e përdorimit të karburantit me punën e kryer.

7. 1 Rekomandim: Bashkia Cërrik të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit dhe ato përmbareme për kërkimin dhe arkëtimin e vlerës **109,200 lekë**.

Brenda muajit qershor 2017

8. Gjetje nga auditimi: Në ish Komunën Mollas me urdhër shpenzim nr. 47/1, datë 20.04.2015 me faturën nr. 6, datë 30.03.2015 për tërheqjen e 1050 litra Diesel është likuiduar subjekti "D..." për vlerën 200,000 lekë. Malli është dokumentuar me fletëhyrje nr. 04, datë 30.03.2015 (1050 x 190.476 lekë litri). Sasia prej 1050 litra është bërë dalje në adresë të mjetin Fadromë të ish-Komunës Mollas z. M.Gj. me fletëdalje nr. 13, datë 30.03.2015 (bashkëlidhur fletëdaljes është vetëm një autorizim i firmosur nga z. A.N. për drejtuesin e mjetit Tip Fadromë, në rubrikën tërheqësi i urdhrit nuk ka asnjë emër apo nënshkrim. Mungon dokumentacioni në lidhje me punën e kryer, si fletë udhëtim, procesverbale, situacione për të justifikuar (argumentuar) përdorimin e karburantit.

8.1 Rekomandim: Bashkia Cërrik të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit dhe ato përmbareme për kërkimin dhe arkëtimin e vlerës **200,000 lekë**, nga z. **M.Gj.** ish- drejtuesi i mjetit Tip Fadromë i cili ka nënshkruar fletëdaljen nr. 13, datë 30.03.2015.

Brenda muajit qershor 2017

9. Në ish Komunën Mollas me urdhër shpenzim nr. 74, datë 10.06.2015 është likuiduar subjekti "D..." shpk për vlerën 200,000 lekë për faturën nr., datë 12.05.2015 që bën fjalë për tërheqjen e **1100** litra Diesel me çmim 181.82 lekë/litra pa tvsh. Malli është bërë hyrje me fletëhyrje nr. 05, datë 12.05.2015 (1100 x 181.82 lekë litri). Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion sasia e mësipërme është bërë dalje në adresë të mjetin Tip Fadromë të Komunës z. F.M. me fletëdalje nr. 17, datë 12.05.2015) ku bashkëlidhur fletëdaljes është vetëm një autorizim i firmosur. Mungon dokumentacioni i punës së kryer, si fletë udhëtimi, procesverbale, situacione për të justifikuar (argumentuar) përdorimin e karburantit.

Nga sasia prej 1100 litra karburant me vlerë 200,000 lekë, sipas daljeve të bëra nga pika e karburantit direkt komunës rezultojnë 394.19 litra, janë tërhequr nga z. F.M. me çmim 175 lekë ndërsa diferenca prej 705.8 litra gazoil me çmim 181.82 lekë/litra (paguar) ose vlera prej **128,328** lekë mbetet e pa argumentuar.

Mungojnë preventivat dhe situacionet për punimet e kryera. Në asnjë rast nuk ka bashkëlidhur asnjë urdhër pune për punën e kryer nga ky mjet. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me paragrafin III pika 35 germa a, b, c. pika 37, 38 e 39. Marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara neni 42, 43 dhe 44 germa a, pika 47, 48 e 50. Transporti i aktiveve pika 51 dhe Kapitulli i IV "Inventarizimi i aktiveve pika 37, të udhëzimit MF nr. 30, datë 27.12.2011" Për menaxhimin e aktiveve në njësit e sektorit publik"

9.1 Rekomandim: Bashkia Cërrik të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit dhe ato përmbareme për kërkimin dhe arkëtimin e vlerës **128,328 lekë** (705.8 litra x 181.8 lekë litri), nga z. **F.M.** i cili ka nënshkruar fletëdaljen nr. 17, datë 12.05.2015.

Brenda muajit qershor 2017

10. Gjetje nga auditimi: Në bashkinë Cërrik, gjatë vitit 2015, me urdhër shpenzim nr. 62, datë 27.02.2015, janë paguar ekipi i futbollit Turbina për shumë 420, 000 lekë për të cilët nuk është llogaritur dhe ndalur tatimi në burim mbi të ardhurat në masën 15 % për vlerën **21,000 lekë** me dëm ekonomik, në shkelje e kërkesave të nenit 33 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

10. 1 Rekomandimi: Nga Bashkia Cërrik të procedohet sipas kërkesave ligjore, për arkëtimin e vlerës prej **21,000 lekë** nga Sportistët e Klubit Turbina (Aneksi nr. 2).

Brenda muajit qershor 2017

11. Gjetje nga auditimi: a- Në bashkinë Cërrik, gjatë vitit 2015, me urdhër shpenzim nr. 150, datë 14.05.2015, është paguar ekipi i futbollit Turbina për shumë 255,000 lekë për të

cilët nga auditimi rezulton se listpagesa nuk është kuadruar **për 5000 lekë** duke u paguar më shumë, shumë e cila mbetet në përgjegjësi të personave përgjegjës.

b- Po në këtë urdhër shpenzim, në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 12.10.2010 “Për trajtimin financiar të punonjëseve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit: Kreu III-të, pika 3, nga Bashkia Cërrrik janë paguar dieta ushqimore dhe shpenzime fjetje (urdhër i brendshëm nr. 34, datë 13.05.2015 për trajtim ushqimor dhe hotel (VKB nr. 188, datë 23.01.2015.). Për shpenzimet e hoteli në **shumën 100,000 lekë** mungon dokumentacioni përkatës, pra nuk disponohet, urdhërsërbimi, fletë hoteli si dhe kasa fiskale.

c-Me urdhër shpenzim nr .181, datë 11.06.2015 për vlerën **60,000 lekë**, Bashkia Cërrrik, bazuar në urdhrin e brendshëm nr.7, datë 09.06.2015, është urdhëruar **pagesa e 24 personave (sportistëve)** për trajtimin ushqimor dhe hotel me nga 2000 lekë secili si dhe të biletave të transportit për ekipin dhe stafin në masën 500 lekë secili.(urdhër shërbimet, i mungojnë fletët e hotelit, fatura elektronike e kasës regjistruese për hotelin, biletat e transportit. Pagesa e kryer është në kundërshtim me VKM nr 997, datë 12.10.2010 “Për trajtimin financiar të punonjëseve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit: Kreu III-të, pika 3. germa a.i. ii, pika b (shpenzimet e fjetjes kundrejt dokumentit tatimor përkatës të paraqitur nga hotele e të shoqëruar me faturën e printuar nga kasa elektronike...”).

11. 1Rekomandimi:

a-Nga Bashkia, Cërrrik të procedohet sipas kërkesave ligjore, për arkëtimin e vlerës prej 5000 lekë, respektivisht nga znj. A.S. 2,500 lekë dhe H K **2500 lekë** secili.

b. Nga Bashkia, të procedohet sipas kërkesave ligjore, për arkëtimin e vlerës prej **160,000** lekë personat e përcaktuar ne **Aneksin nr. 2** bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 30.06.2017

12. Gjetje nga auditimi : Sipas urdhër prokurimit nr. 25/1, datë 09.11.2015 procesverbalit datë 09.11.2015 për blerje me vlerën nën 10,000 lekë, mbajtur nga komisioni i blerjeve të vogla i përbërë nga z. H.K. V.M. dhe E.K. me urdhër pagesën nr. 631, datë 22.12.2015 janë blerë karta rimbushëse **në vlerën 10,000 lekë**. Likuiduar biznesi z. E.Xh. me faturën tatimor nr. 161 datë 04.12.2015 për vlerën 10,000 lekë. Për këtë blerje mungon kërkesa nga përdoruesi, mungon fletë hyrja e magazinës.

12.1. Rekomandimi: Nga Bashkia, të procedohet sipas kërkesave ligjore, për arkëtimin e vlerës prej **10,000 lekë** në mënyrë të barabartë me **vlerën 334 lekë/secili** nga anëtarët e komisionit të blerjeve në vlera të vogla, respektivisht; H.K. E.K. dhe V.M.

Brenda datës 30.06.2017

MASA PËR MOSPËRDORIM ME EFEKTIVITET TË FONDEVE (3 E-të):

1. Gjetje nga auditimi: Në prokurimin publik me objekt **“Rikonstruksioni i rrugës Shalës-Gjyrale”** KVO-së me përzgjedhjen e ofertës fituese në kundërshtim me nenet 20, 46, 53, 54 të ligjit Nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, kreu V i VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ka sjell efekt financiar negativ për përdorim me mos eficence të buxhetit të NjQV ish-Komuna Shalës, në vlerën 1,235,115 lekë.

1. Rekomandim: Bashkia Cërrrik të marrë masat të analizoj me grup pune të veçantë duke nxjerr shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorimin me efektivitet, ekonomikitet dhe eficence të fondeve publike për procedurën e prokurimit me efekte negative në përdorimin e fondeve publike në vlerën 1,235,115 lekë duke vënë theksin në rritjen e vlerës së shtuar nga përdorimi i fondeve publike në shërbim të komunitetit.

2. Gjetje nga auditimi:Në prokurimin publik me **objekt “Rruga “Unaza e Klosit”**, KVO-së me përzgjedhjen e ofertës fituese në kundërshtim me nenet 20, 46, 53, 54 të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, kreu V i VKM nr. 1, datë 10.01.2007

“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ka sjell efekt financiar negativ për përdorim me mos efience të buxhetit të ish-Komuna Klos në vlerën 2,760,700 lekë.

2. Rekomandim: Nga Bashkisë Cërrik të merren masat të analizoj me grup pune të veçantë duke nxjerr shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorimin me efektivitet, ekonomikitet dhe efience të fondeve publike për procedurën e prokurimit me efekte negative në përdorimin e fondeve publike në vlerën 2,760,700 lekë duke vënë theksin në rritjen e vlerës së shtuar nga përdorimi i fondeve publike në shërbim të komunitetit.

C. MASA DISIPLINORE

1.Për punonjësit që janë pjesë e shërbimit civil.

C.I Mbështetur në nenin 58 “llojet e masave disiplinore” shkronja “b” të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe nenin 64 shkronjat **g** dhe **k** të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Cërrik, që ti kërkojë Komisionit disiplinor të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

c.2-“Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj” e parashikuar në nenin 58, shkronja “b” **për 5 punonjësit** si më poshtë:

- 1. zj. F.F.** ish Përgjegjëse zyrës Taksave, aktualisht Drejtore e Drejtorise Taksave Bashkia Cërrik,
- 2. zj. E.D.** ish- specialiste e taksave , aktualisht Përgjegjëse e Zyrës Taksave Bashkia Cërrik,
- 3. zj. Xh.D.** Specialiste kontrollit sekuestros Bashkia Cërrik,
- 4. zj. A.D.** Specialisti i Taksave të biznesit Madh Bashkia Cërrik,
- 5. zj. R.F.** Specialisti i Taksave dhe tarifave popullata Bashkia Cërrik.

-Për mos organizim të punës dhe mos kryerja e detyrave, në Bashkinë Cërrik dhe për mos kontroll ndaj 4 Njësi Administrative Mollas, Klos, Gostimë dhe Shalës, pasi deri më datën 03.03.2017 kanë debitorë për tarifave dhe taksat vendore duke krijuar të ardhura të munguara në vlerën **47,763,342** lekë.

-Nuk kanë nxjerrë listat e debitorëve të biznesit dhe qirave për tokat bujësore të pandara në fund të viteve 2014,2015 dhe 2016 dhe nuk i kanë dërguar zyrtarisht në Zyrën e financës për tu kontabilizuar dhe pasqyruar si debitorë në bilancet kontabël, në kundërshtim me nenet 6 dhe 7 të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” .

-Nuk janë nxjerrë njoftime vlerësimet tatimore dhe nuk janë ndjekur procedurat ligjore për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore, veprime apo mos veprime të cilat kanë ardhur si pasojë e moskryerjes së detyrave që lidhen me vjeljen brenda afatit të caktuar ligjor të taksave dhe tatimeve nga punonjësit e organeve tatimore dhe personat e tjerë zyrtarë që janë ngarkuar me këto detyra, në kundërshtim me nenet 70 pika 3, 90, 91 dhe 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar.

c.3.Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet” parashikuar në nenin 58 shkronja (c), **për 3 punonjësit** si më poshtë:

1. z. A.T. me detyrë K/Inspektor i IMT-së, për:

- Nuk ka gjurmë shkresore për zbatimin e planeve të punës, duke mos përmbushur detyrimet ligjore dhe mos zbatimin e plotë të kërkesave të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit” i ndryshuar, VKM-së nr. 862, datë 05.12.2007 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga INUK dhe INUV” i ndryshuar.

2. zj. A.Xh. detyrë përgjegjës sektori Juridik,

3. zj. A.Ll. me detyrë përgjegjëse e SAMT, për:

- Mos kryerjen e inventarizimit fizik të pronave, duke mos i vënë nën administrim dhe duke mos i përfshirë në inventarin kontabël pasuror për të ruajtur funksionimin e destinacionit të tyre për të mundësuar krijim të ardhurash. Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me nenin 7 të ligjit nr. 9228, datë 29.04. 2004, “Për kontabilitetin dhe për pasqyrat financiare”, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, ligjin nr 8652, datë 31.7.2000 ”Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore” dhe kreu IV, pika 74, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Për periudhën objekt auditimi, nga pronat e kaluara me VKM nr. 946, datë 02.09.2009 asnjë pronë nuk dërguar për regjistrim në ZVRPP Elbasan, në këto rrethana konstatohet se bashkia nuk ka ndërmarrë hapat e nevojshme ligjore për regjistrimin e të gjithë pasurive, duke sjell mos përmbushje të detyrimeve ligjore të përcaktuara në VKM nr. 500 datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar.

C/2. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen sipas Kodit Punës.

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, shkronja “e” dhe “ç” të nenit 11, kreun IV, dhe nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të kontratës individuale të punës, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave, “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna” për 9 punonjësit e mëposhtëm:**

1. zj. V.B. Administratori i Njësisë Administrative Gostime

2. z. K.B. Specialist i Taksave Gostime

Nga moskryerja e detyrës në lidhje me arkëtimin e debitorëve Njësia Administrative **Gostimë** deri më datën 03.03.2017 ka debitorë për tarifatat dhe taksat vendore duke krijuar të ardhura të munguara në vlerën **6,975,191** lekë, **respektivisht;** 18 biznese private në vlerën 532,191 lekë, 1106 Fermerë për taksën e tokës në vlerën 5,099,000 lekë, debitorë për ndërtesat në vlerën 1,344,000 lekët në kundërshtim me pikën 71, të udhëzimit plotësues të Ministrisë Financave nr. 01, datë 15.01.2016 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016”.

3. z. Xh.S. Administratori i Njësisë Administrative Mollas

4. zj. E.Ç. Specialiste e Taksave Mollas

Nga moskryerja e detyrës në lidhje me arkëtimin e debitorëve Njësia Administrative **Gostimë** deri më datën 03.03.2017 ka debitorë për tarifatat dhe taksat vendore pa u likuiduar duke krijuar të ardhura të munguara në vlerën **30,266,607** lekë, ose 70% të totalit të debitorëve, në kundërshtim me pikën 71, të udhëzimit plotësues të MF nr. 01, datë 15.01.2016 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016”.

5. z. Y.M. Administratori i Njësisë Administrative Klos

6. zj. M.K. Specialiste e Taksave Klos

Nga moskryerja e detyrës në lidhje me arkëtimin e debitorëve Njësia Administrative **Klos** deri më datën 03.03.2017 ka debitorë për tarifatat dhe taksat vendore pa u likuiduar duke krijuar të ardhura të munguara në vlerën **2,730,500** lekë, në kundërshtim me pikën 71, të udhëzimit plotësues të Ministrisë Financave nr. 01, datë 15.01.2016 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016”.

7. z. A.Sh. administrator i Njësisë Administrative Shalës

8. zj. E.A. Specialiste e Taksave Shalës.

Nga moskryerja e detyrës në lidhje me arkëtimin e debitorëve Njësia Administrative **Shalës** deri më datën 03.03.2017 ka debitorë për tarifatat dhe taksat vendore pa u likuiduar duke krijuar të ardhura të munguara në vlerën **4,320,625** lekë, ose të totalit të debitorëve, në kundërshtim me pikën 71, të UMF nr. 01, datë 15.01.2016 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2016”.

9.Sh.L. në cilësinë e topografit në ish-komunës Shalës dhe më vonë specialist kadastre në Njësinë Administrative Shalës.

-Ka shkëlur VKM nr. 121, datë 17.02.2011 “Mënyra e ushtrimit të funksioneve nga drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qarqe dhe zyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në komuna dhe bashki” Kreu IV, pika 2, shkronja c.

-Për mos kontroll për dhënien me qira të sipërfaqes prej 96 ha 121 personave për tokat e pandara, për mos ushtrim kontrolli në lidhje me respektimin e kushteve të kontratës, në kundërshtim me pikën 5 të UKM nr. 1, datë 18.07.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore, të pandara”.

D. MASA ADMINISTRATIVE

D. 1. Për Agjencinë e prokurimit publik.

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në procesverbalet, vërejtjeve komentet e subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit përfundimtar të auditimit.

Mbështetur në nenet 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe bazuar në nenin 15 shkronja (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara**, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo rekomandimin autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), **14 punonjësve** si më poshtë:

1.1 Të vlerësoj dhe të marrë masa ndaj Titullarit të Autoritetit Kontraktor të **ish-komunës Shalës, konkretisht:**

z. V.M. në cilësinë e Titullarit të AK-së;

1.2 Të vlerësoj dhe të marrë masa ndaj anëtarëve të Njësisë së Prokurimit të ish-komunës Shalës, *konkretisht:*

1. z. L.S. në cilësinë e juristit,

2. z. Sh.L. në cilësinë e anëtarit,

3. z. H.C. në cilësinë e anëtarit,

1.3 Të vlerësoj dhe të marrë masa ndaj anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të ish-komunës Shalës, *konkretisht:*

1. z. S.L. në cilësinë e anëtarit të KVO-së,

3. z. N.Xh. në cilësinë e anëtarit të KVO-së,

4. z. Z.T. në cilësinë e anëtarit të KVO-së.

Për procedurën e prokurimit publik me objekt: **“Rikonstruksioni i Rrugës Shalës-Gjyralë, Komuna Shalës”:**

-Në Urdhrin e Prokurimit përveç Njësisë së Prokurimit janë përcaktuar edhe anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, veprim ky në kundërshtim me pikën 1, germa “ç”, me pikën 2, germa “ç” të Kreu V të VKM nr. 1, datë 10.01.2007, pasi janë përcaktuar dhe anëtarët e KVO-së në urdhrin e prokurimit.

-Në urdhër prokurimit me përjashtim të preventivit mungojnë aktet mbi të cilat janë bërë përlllogaritjet e zërave në kundërshtim me Kreun V, pika 1/ç, VKM nr. 1, date 10.01.2007 "Për Rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar.

-NJP nuk ka justifikuar dhe dokumentuar argumentimin e vendosjes së kritereve specifike për kualifikim, në kundërshtim me pikën 2, germa “a” Kreu V të VKM-së nr. 1, datë 10.01.2007.

-NJP nuk kanë përlllogaritur dhe arsyetuar fondin limit për procedurën e prokurimit në zbatim të gërmës “c” e pikës 2 të kreut II të VKM nr. 1, datë 10.01.2007.

Nga auditimi konstatohet se KVO ka mbajtur procesverballi i vlerësimit të ofertave më datë 06.2013, ku ka vlerësuar:

S’kualifikimin:

1. OE “V...”, mbas verifikimeve të dokumentacionit ligjor, teknike, dhe ekonomike, konstatohet se dokumentacioni nuk është i plotë dhe ky operatore skualifikohet për arsyet si me poshtë:

Operatori ekonomikë skualifikohet pasi nuk ka sjellë dokumentacionet teknike, financiare dhe nuk ka paraqitur ofertë ekonomike duke mos përmbushur kriteret e veçanta., vlera ekonomike e paraqitur në ofertë është s’ka Lekë pa TVSH.

2. OE “H...”, mbas verifikimeve të dokumentacionit ligjor, teknike, dhe ekonomike, konstatohet se dokumentacioni nuk është i plotë dhe ky operatore skualifikohet për arsyet si me poshtë: OE skualifikohet pasi dokumentacioni i mjeteve nuk i ka të shoqëruara me taksat përkatës si dhe lidhur me punët e ngjashme nuk janë të shoqëruara me dokumentacionet e kërkuara si dhe nuk përmbushin vlerën e kërkuara nga ana jonë duke mos përmbushur kriteret e veçanta. Vlera ekonomike e paraqitur në oferte është **24,045,000 lekë pa TVSH.**

Kualifikimin:

1. OE “E...” mbas verifikimeve të dokumentacionit ligjor, teknike, dhe ekonomike, konstatohet se dokumentacioni është i plotë dhe ky operator rezulton i suksesshëm. Vlera ekonomike e paraqitur në ofertë është **25,280,115 Lekë pa TVSH.**

Nga KVO në vend të parë është përcaktuar OE “E...” me vlerë **25 280 115 (njëzet e pesë milion e dyqind e tetëdhjetë mije e njëqind e njëmbëdhjetë) Lekë pa TVSH.**

Nga auditimi në sistem elektronik të procedurës së vlerësimit dhe dokumentacionit ligjor të paraqitur nga OE pjesëmarrës, rezulton: 2 nga 3 operatorët pjesëmarrës në procedurë janë skualifikuar.

Vlerësojmë se vlerësimi i KVO-së gjatë shqyrtimit të ofertave duhet të kishte qenë me fleksibël, në zbatim të ligjit, duke pasur në konsideratë kriterin e vlerësimit të “*ofertës më të ulët*” dhe gjatë procesit të kishte kualifikuar dhe **OE “H...” me ofertë ekonomike 24,045,000.** Duke vlerësuar faktin se është oferta ekonomike e favorshme dhe nuk do të sillte deformim të ofertës në përmbushje të detyrimeve të nenit 53 dhe 54 të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”. Mangësitë e konstatuar nga KVO hynë te devijimet e vogla dhe KVO duhet ti kishte kërkuar arsyetim operatorit konkurrues duke parë ofertën ekonomike favorizuese të këtij operatori.

Për sa më sipër, Vlerësimi i KVO-së është në kundërshtim me nenet 20, 46, 53, 54 të ligjit Nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, kreu V i VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pasi ka skualifikuar ofertues të cilët plotësojnë kriteret për kualifikim me devijime të vogla, **si rrjedhojë ka sjell efekt financiar negativ dhe mos përdorimin me eficence nga ish-Komuna Shalës me përzgjedhjen e ofertës fituese në vlerën 1,235,115 lekë.**

2.1 Të vlerësoj dhe të marrë masa ndaj Titullarit të Autoritetit Kontraktor të **ish-komunës Klos, konkretisht:**

z. B.H. në cilësinë e Titullarit të AK-së;

2.2 Të vlerësoj dhe të marrë masa ndaj anëtarëve të Njësisë së Prokurimit të ish-komunës Klos, konkretisht:

1. z. G.L. në cilësinë e juristit,

2. z. E.P. në cilësinë e anëtarit,

3. z. A.S. në cilësinë e anëtarit,

2.3 Të vlerësoj dhe të marrë masa ndaj anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të ish-komunës Klos, konkretisht:

1. z. N.Sh. në cilësinë e anëtarit të KVO-së,
3. z. M.B. në cilësinë e anëtarit të KVO-së,
4. z. Q.M. në cilësinë e anëtarit të KVO-së.

Për procedurën e prokurimit publik me objekt: “Rruga Unaza e Klosit”:

-Në Urdhrin e Prokurimit përveç Njësisë së Prokurimit janë përcaktuar edhe anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, veprim ky në kundërshtim me pikën 1, gërma “ç”, me pikën 2, gërma “ç” të Kreu V të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për Rregullat e Prokurimit Publik” i ndryshuar, pasi janë përcaktuar dhe anëtarët e KVO-së në urdhërin e prokurimit.

-Konstatohet se, bashkëlidhur urdhër prokurimit me përjashtim të preventivit të punimeve nuk janë dokumentet origjinale konform VKM nr. 1, datë 10.01.2007 "Për Rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar, Kreu V, pika 1/ç; Ligji për "Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" Nr. 10296, datë 08.07.2010, neni 15, 22. VKM nr. 1, date 10.01.2007 "Për Rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar, Kreu V pika 1/ç, pasi mungojnë aktet mbi të cilat janë bërë përlogaritjet e zërave të preventivit.

-NJP nuk ka justifikuar dhe dokumentuar argumentimin e vendosjes së kriterëve specifike për kualifikim, në kundërshtim me pikën 2, gërma “a” Kreu V të VKM-së nr. 1, datë 10.01.2007 i ndryshuar.

-NJP nuk kanë përlogaritur dhe arsyetuar fondin limit për procedurën e prokurimit që kanë çelur, në asnjë rast nuk bazohet në asnjë nga parashikimet e përcaktuara nga gërma “c” e pikës 2 të kreut II të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 sipas të cilit në llogaritjen e fondit limit të kontratës AK duhet të ketë parasysh çmimet e botuara nga INSTAT, çmimet e tregut, kontratat e mëparshme, dhe çmimet ndërkombëtare.

Nga KVO është mbajtur procesverbali i vlerësimit të ofertave më dt 23.10.2012, ku ka vlerësuar:

S’kualifikimin:

KVO ka s’kualifikuar ofertën e paraqitur nga OE “E...” sh.p.k me ofertë ekonomike **15,403,840 lekë pa TVSH**, sepse nuk ka paraqitur dokumentacionin e plote dhe te sakte për të dëshmuar të gjithë plotësimin e kërkesave për kualifikim. Konkretisht Operatori nuk ka arritur të paraqesë, Sigurim e ofertës siç është kërkuar në DST, nuk ka arritur të paraqesë preventivin e ofertës. Ofertuesi gjithashtu nuk ka arritur të paraqesë dokumentacionin e plote shoqërues për makineritë që ka paraqitur në shtojca 8 e DT. Mungojnë dokumentat shoqërues për nyje, përpunim inerte, asfaltoshtruese, fabrike asfaltbetoni.

Kualifikimin:

1. OE “A...” me ofertë ekonomike 18,167,565 lekë pa TVSH

2. OE “V...” me ofertë ekonomike 18,164,540

Janë kualifikuar sepse dokumentacioni i paraqitur është i plotë.

Me formularin e njoftimit të fituesit dt 19.09.2012 është shpallur fitues, OE “V...” shpk.

Më datë 19.09.2012 është mbajtur procesverbali përmbledhës dhe i vlerësimit të ofertave dhe renditjes së tyre sipas kriterit të ofertës me vlerë më të vogël dhe i është propozuar Titullarit të AK lidhja e kontratës me OE “V...” sh.p.k me ofertë ekonomike **18,164,540 lekë pa TVSH**. Më datë 19.09.2012 është bërë njoftimi i fituesit në APP dhe më datë 09.10.2012 është nënshkruar kontrata midis Titullarit të AK dhe OE të shpallur fitues.

Për procedurën e prokurimit nuk ka ankesa nga OE e tjerë pjesëmarrës.

Nga auditimi në sistem elektronik të procedurës së vlerësimit dhe dokumentacionit ligjor të paraqitur nga OE pjesëmarrës, rezulton:

Vlerësojmë se vlerësimi i KVO-së gjatë shqyrtimit të ofertave duhet të kishte qenë me fleksibël, në zbatim të ligjit, duke pasur në konsideratë kriterin e vlerësimit të “*ofertës më të ulët*” dhe gjatë procesit të kishte kualifikuar dhe OE “E...” me ofertë ekonomike **15,403,840 lekë pa tvsh** dhe ti jepte mundësi për plotësimin e dokumenteve shoqëruese të makinerive deri në momentin e lidhjes së kontratës ose mund të bënte verifikim të drejtpërdrejtë të automjeteve dhe dokumentacionit të OE konkurrues, mbi arsyet e skualikimit të mungesës së

sigurimit të ofertës dhe preventivit, vlerësojmë se sigurimi i ofertës dhe preventivi janë dokumente të cilat bëhen të detyrueshme për OE në momentin e lidhjes së kontratës, pasi komisioni vlerëson formularin e ofertës gjatë vlerësimit të ofertave, duke pasur në konsideratë kriterin e vlerësimit **“Oferta më e ulët”**. Duke vlerësuar faktin se është *oferta ekonomike e favorshme dhe nuk do të sillte deformim të ofertës në përmbushje të detyrimeve kontraktuale që mund të pasonin pas kualifikimit të këtij operatorit dhe në interpretim të nenit 53 dhe 54 të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”*, mangësitë e konstatuar nga KVO hynë te devijimet e vogla dhe KVO duhet ti kishte kërkuar arsyetim dhe mundësi të plotësisimit të operatorit konkurrues deri në momentin e lidhjes së kontratës duke parë ofertën ekonomike favorizuese të këtij operatori. Për sa më sipër, Vlerësimi i KVO-së është në kundërshtim me nenet 20, 46, 53, 54 të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, kreu V i VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pasi ka skualifikuar ofertues të cilët plotësojnë kriteret për kualifikim me devijime të vogla të pranura nga ligji, *si rrjedhojë ka sjell efekt financiar negativ për përdorimin me mos eficence nga NJQV ish-Komuna Klos me përzgjedhjen e ofertës fituese në vlerën 2,760,700 lekë.*

D2.Për Ministrinë e Drejtësisë (Heqje Licence për noterin Publik)

Për shkeljet e konstatuara në dokumentet shkresore të hartuara, pranura dhe noterizuara, për dhënien me qira të tokave bujqësore të pandara, bazuar në nenin 8 shkronja “ç” të ligjit nr. 7829, datë 01.06.1994 *“Për Noterinë” i ndryshuar, i rekomandojmë, Ministrinë të Drejtësisë, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave përkatëse në raport me shkeljet e konstatuara në 5 (pesë) kontrata, për noterin publike znj. A.L. konkretisht:*

1. Kontrata Rep. nr. 1776, Kol. nr. 941, datë 27.03.2013, për noterizimin e kontratës nr. 80, datë 20.01.2013, lidhur midis kryetarit të Komunë Shalës dhe shtetasit M.K. për sipërfaqen 5 ha me afat 60 vjet. (Kontrata nuk është TIP)

2. Kontrata Rep. nr. 857, Kol. nr. 37223, datë 30.12.2013, për noterizimin e kontratës nr. 74, datë 02.07.2013, lidhur midis kryetarit të Komunë Shalës dhe shtetasit Xh.Q. për sipërfaqen 0,6 ha me afat 90 vjet.

3. Kontrata Rep. nr. 5858, Kol. nr. 2973, datë 25.09.2013, për noterizimin e kontratës nr. 111, datë 01.07.2013, lidhur midis kryetarit të Komunë Shalës dhe shtetasit B.A. për sipërfaqen 2 ha me afat 90 vjet.

4. Kontrata Rep. nr. 750, Kol. nr. 485, datë 13.02.2015, për noterizimin e kontratës nr. 112, datë 21.09.2013, lidhur midis kryetarit të Komunë Shalës dhe shtetasit Ç.H. për sipërfaqen 2 ha me afat 90 vjet.

5. Kontrata Rep. nr. 5860, Kol. nr. 2974, datë 25.09.2013, për noterizimin e kontratës nr. 115, datë 01.07.2013, lidhur midis kryetarit të Komunë Shalës dhe shtetasit H.L. për sipërfaqen 2 ha me afat 90 vjet. Njëkohësisht rezulton se kjo kontratë është e noterizuar edhe në emër të shtetasit Sh.A. me date 30.06.2014.

Për 5(pesë) kontratat e mësipërme konstatohen shkeljet e mëposhtme:

1. Hartimi dhe noterizimi i 5 (pesë) kontratave është kryer pa përmbushur detyrimin ligjor të përcaktuar në ligjin nr. 7829, datë 01.06.1994 *“Për Noterinë”, i ndryshuar, neni 54, ku përcaktohet: Akti noterial për tjetërsimin ose njohjen e pronësisë mbi sendet e paluajtshme, ose të një të drejte reale mbi to, kryhet nga noteri, pasi të ketë verifikuar pronësinë e palës mbi sendin e paluajtshëm. Për këtë qëllim pala i paraqet noterit dokumentet e pronësisë dhe noteri, me pëlqimin e saj, verifikon gjendjen juridike të pronësisë në regjistrin elektronik të pasurive të paluajtshme....”*

2. Pasuritë objekt i marrëdhënies kontraktuale të noterizuar, rezultojnë se nuk i janë transferuar ish- komunës Shalës, Qarku Elbasan, në zbatim të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 *“Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”*,

nenit 18, ku përcaktohet se: Të gjitha pronat, të cilat u kalohen në pronësi njësive të qeverisjes vendore sipas këtij ligji, do të regjistrohen në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, me pronar njësinë përkatëse të qeverisjes vendore, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Po kështu do të regjistrohen në kartelën e pasurisë së paluajtshme edhe kushtet dhe kufizimet e vendosura sipas këtij ligji.

3. Pasuritë objekt i marrëdhënies kontraktuale të noterizuar, rezultojnë se nuk janë inventarizuar dhe transferuar ish-komunës Shalës, Qarku Elbasan, me VKM sipas procedurës të përcaktuar në VKM nr. 500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar.

Në rrethanat ku pasuritë objekt i marrëdhënies kontraktuale të noterizuar nuk është në pronësi të ish- komunës Shalës, objekti i këtyre marrëdhënieve kontraktuale nuk përmbush detyrimet ligjore të sanksionuara në nenin 678, të Kodit Civil, ku përcaktohet se: “Objekti i kontratës duhet të jetë i mundshëm, i ligjshëm, i caktueshëm ose që mund të përcaktohet”. Mungesa e tagrit të pronarit apo përdoruesit të ish-komunës Shalës, në cilësinë e “qiradhënësit”, i bën marrëdhëniet kontraktuale absolutisht të pavlefshme dhe në papajtueshmëri me dispozitat ligjore dhe nënligjore të sipërcituara.

4. Njëherazi konstatohet se kontratat e noterizuara nga noteria publike për dhënie me qira të tokave bujqësore të pandara, me afat nga 60 deri në 90 vjet, janë në kundërshtim me kontratën TIP, të miratuar me Urdhrin e MBU nr. 13, datë 15.01.2013 “Për miratimin e përmbajtjes dhe formës së “Kontratës Tip për dhënie me qira të tokave bujqësore, të pandara”. Një element i rëndësishëm që nuk është sanksionuar në këto kontrata është detyrimi i vendosjes së sanksioneve në masën 1% për çdo ditë vonesë, për mos dorëzimin e tokës qiramarrësit dhe për pagesën me vonesë të qirasë prej qiramarrësit.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Njësive të Qeverisjes Vendore dhe Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R